



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:104626
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05439834

Rev.nr.49/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - jokontestimore të propozuesit: H. B. nga fshati X., Komuna e R., të cilin e përfaqëson E. B. avokat në Gj., sipas autorizimit, kundër kundërpropozueses: Organi Shpronësues, Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja V. Sh., sipas autorizimit, për caktimin e vlerës të paluajtshmërisë së shpronësuar, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.225/2020, të datës 10.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i kundërpropozueses: Organi Shpronësues, Komuna e Gjakovës, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.225/2020, të datës 10.11.2023.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm CN.nr.201/2018, të datës 08.11.2019, është vendosur: Caktohet kompensimi për paluajtshmërinë e shpronësuar të ish pronarit H. B. nga fshati X., Komuna e R., për parcelat kadastrale nr. ...-ZK- Gj., jashtë qytetit, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€, për parcelën kadastrale nr.... K-1, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€ dhe nr.... K-0, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€, përkatësisht shuma e përgjithshme prej ... €. Obligohet kundërpëropozuesja Komuna e Gjakovës, si shfrytëzuese e pasurisë së shpronësuar që ish pronarit H. B. nga fshati X., Komuna e R., në emër të paluajtshmërisë së shpronësuar të përcaktuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij

aktvendimi, t'ia kompensojë shumën e përgjithshme prej ...€, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej ... €, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi e nën kërcënim të përmbarimit.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.225/2020, të datës 10.11.2023, është vendosur: Refuzohet e pathemeltë ankesa e kundërpropozuesit, Komuna e Gjakovës, "Organi Shpronësues", ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.201/2018, i datës 08.11.2019, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion kundërpropozuesja, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, të aprovojë revizionin duke e ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë ose çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi, më datë..., në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur propozim kundër kundërpropozueses, për caktimin e vlerës të paluajtshmërisë së shpronësuar, duke kërkuar më saktësisht si në parashtresën për precizim të propozimit të datës....

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas propozimit të propozuesit, ndaj kundërpropozueses, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktvendimin e atakuar CN.nr.201/2018, të datës 08.11.2019, me të cilin e ka aprovuar propozimin e propozuesit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: Vendimin përfundimtar të Komunës së Gjakovës, ... nr...., të datës... , Historiatin e parcelave të shpronësuara i përpiluar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, me nr. punes..., të datës..., ekspertizën e datës ...dhe ekspertizën e datë ...(dhe është sqaruar në të njëjtën ekspertizë në shqyrtimin e fundit), dhe pas vlerësimit dhe analizimit të provave relevante veç e veç, e në mbështetje të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesa e precizuar e propozuesit në shqyrtimin kryesor të datës..., është e themeltë.

Ka shtuar se gjykata në rastin konkret me propozimin e palës aktive në procedurë, ka caktuar ekspertizë e cila është hartuar nga eksperti i licencuar për vlerësimin e pronave të paluajtshme F. S., i cili bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, të cilat i ka pasur në disponim dhe vrojtimin e drejtpërdrejtë në paluajtshmërinë e cila është objekt vlerësimi në këtë çështje jokontestimore, dhe të cilat paluajtshmeri kanë qenë pronë legjitime e këtu propozuesit dhe e cila i është shpronësuar nga ana e këtu kundërpropozuesit për interes publik dhe nuk i është kompensuar deri më tani, e ka vlerësuar sipas çmimeve reale në treg, në lartësinë e përgjithshme prej ...€.

Lidhur me këtë vlerësim eksperti ka pasur parasysh edhe faktin se paluajtshmëria e shpronësuar ka qasje direkt në rrugën kryesore Gj. – P., me një gjerësi prej 81m, dhe në distancë rreth ...m, me rreth rrotullimin në hyrje të qytetit. Të njëjtat parcela me vendimin ..., nr...., të datës..., janë shndërruar nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Afër parcelave të lartcekura, ka objekte afariste që kanë veprimtari biznese, pika karburanti etj. Vlera e tregut është përcaktuar sipas Komitetit Ndërkombëtar të Standardeve, për vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe TEGOVA - Grupit Evropian të vlerësuesve, si: “Vlera e tregut është sasia e vlerësuar për të cilën një pasuri do të shkëmbehet në datën e vlerësimit, midis blerësit dhe shitësit të vullnetshëm, në një transaksion pas marketingut të duhur, ku secila palë ka vepruar me koshijencë, me kujdes dhe pa detyrim”. Treguesi më i mirë i vlerës së tregut është çmimi aktual me të cilin është shitur pronë. Duke u bazuar në informacionet e grumbulluara nga tregu i pasurive për pronat e ngjashme në zonë dhe nga ofertat e tregut, nga ana e ekspertit është kryer analiza e nevojshme për të përcaktuar një vlerë tregu, sa më reale të pronës - objekt vlerësimi. Në përcaktimin e kësaj vlere, reflektohen të gjitha faktorët që ndikojnë në shitblerjen e pronës, sikurse mund të jenë : vendndodhja, madhësia, zhvillimi urban i zonës, kushtet, komoditet, shërbimet komunale, transporti urban, rrugët, tendenca e tregut të pasurive të paluajtshme, etj. Meqë pronë e vlerësuar është tokë ndërtimore, gjatë vlerësimit edhe një fakt i këtille ka pasur relevancë dhe në këtë kontekst, vlera e pronës është llogaritur duke u bazuar në krahasimet e drejtpërdrejta sipas referencave të tregut në zonën ku ndodhet paluajtshmëria e vlerësuar. Eksperti ka përdorur metodën e shitjeve krahasuese për këtë vlerësim, ka mbledhur të dhëna statistikore nëpër institucione të besueshme; siç janë: kontratat e shitblerjeve në disa vite të fundit, në zonën ku ndodhet pronë (dhe këto kontrata të legalizuara te noterët kompetent, nuk ia ka bashkëngjitur ekspertizës - me motivacion se palët kontraktuese shqetësohen nga fakti se pikërisht kontratat e tyre janë bërë publike - mirëpo të gjitha të dhënat në këtë kontekst, mund të vërtetohen në Zyra Kadatrale në Gjakovë, apo edhe në zyrat noteriale, ku janë përpiluar ato kontrata), kështu që përfundimisht ka ardhur deri tek çmimi real i tregut, i paluajtshmërisë së shpronësuar: për parcelën kadastrale nr.... ZK – Gj., jashtë qytet, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€., për parcelën kadastrale nr...., ZK – Gj., jashtë qytet, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€ dhe nr...., ZK – Gj., jashtë qytet, për sipërfaqen prej ... m², shuma prej ...€, përkatësisht shuma e përgjithshme prej ...€, e të cilin vlerësim eksperti e ka nxjerrë në bazë të analizave dhe faktorëve të lartcekur, duke e arsyetuar në mënyrë shkencore dhe profesionale, për çka një lartësi e këtille, e vlerësimit të paluajtshëmrisë së shpronësuar të këtu propozuesit, e aprovon edhe gjykata faktike.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 13 dhe 28, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme (“Ligji nr.03/L-139, i datës 26.03.2009”), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra (“Ligji nr.03/L-205, i datës 20.10.2010”). Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 452 paragrafi 2 të LPK-së.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kundërpropozuesja ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.nr.225/2020, të datës 10.11.2023, ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e kundërpropozueses, ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit ndër të tjera ka theksuar se: e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, konform nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk ekzistojnë as shkeljet e Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktvendimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktvendimit e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

Pretendimi se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktvendimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktvendimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktvendimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktvendimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Me nenin 15 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme: “ 1. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni.

2. Kompensimi përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit të shpronësuar si pasojë e shpronësimit plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke përfshirë – nëse është e aplikueshme - pjesët aksesore dhe frutat e saj.”.

Me nenin 16 paragrafi 2 pika 2,1 dhe 2,2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 2. Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose përfituesi i pritur - nëse ka të këtillë - që t’ua paguajë shumën e kompensimin të përcaktuar në vendimin përfundimtar, pronarit të prekur ose zotëruesit të interesit. Kompensimi i kërkuar në vendimin përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 19 2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të vendimin përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore ”.

Me nenin 28 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Përveç, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, gjatë periudhës dhjetë (10) vjeçare pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar, personi i shpronësuar ka të drejtën e refuzimit të parë nëse Organi Shpronësues vendos t’ia shesë ose bartë të drejtat pronësore në pronën përkatëse një pale të tretë private për t’u shfrytëzuar për një qëllim që nuk është qëllim i ligjshëm publik ”.

Me nenin 36 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një vendim përfundimtar, çdo pronar ose zotërues i interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t’i paguhen atij pronari dhe/ose zotëruesi të interesit.. 29 2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Me nenin 138 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Nëse Organi Shpronësues nxjerr një vendim preliminar sipas nenit 10 të këtij ligji në të cilin përcakton se qëllimi përkatës publik e arsyeton shpronësimin e një pjese të pronës së paluajtshme dhe/ose të drejtave të kësaj prone të paluajtshme, dhe pronari ose zotëruesi i interesit të kësaj prone dhe/ose këtyre të drejtave ka arsye të mira dhe të mjaftueshme për të besuar se qëllimi përkatës publik mund të arrihet përmes shpronësimit vetëm të një pjese të pronës së paluajtshme dhe/ose të drejtave në atë pronë të paluajtshme, atëherë ai pronar ose zotërues i interesit ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente në përputhje me nenin 35 të këtij ligji dhe të kërkojë nga gjykata nxjerrjen e një aktgjykimi me të cilin urdhërohet Organi Shpronësues që të zvogëlojë fushëveprimin e vendimit preliminar me qëllim të përjashtimit të asaj pjese të pronës dhe/ose të drejtave të pronarit ose zotëruesit të interesit të cilat nuk nevojiten për arritjen e qëllimit publik. Të gjitha ankesat e parapara në këtë nen duhet të dorëzohen në gjykatë brenda afatit të përcaktuar në nenin 35 të këtij ligji.”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, me të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur e kanë aprovuar kërkesëpadinë e propozuesit për parcelat e shpronësuar dhe atë parcelën kadastrale nr.... – Gj., jashtë qytet, për sipërfaqen prej ... m², parcelën kadastrale nr. ...K-1, për sipërfaqen prej ...m², dhe nr.... K-0, për sipërfaqen prej ... m².

Për arsye se kjo rregullohet edhe me nenin 46 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilën përcaktohet se: “ E drejta e pronës është e garantuar ”.

Po ashtu, me nenin 1 të Protokollit 1, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, përveç tjerash, përcaktohet se: “ Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Po ashtu me nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: ” Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni, të cilat me rastin e vendosjes së çështjes, janë marrë për bazë edhe nga gjykatat e instancës më të ulët ”.

Përveç të cekurave, aktvendimi i goditur, është i bazuar edhe në ekspertizën e kryer në mënyrë profesionale nga eksperti i gjeodezisë B. M. - inxhinier i diplomuar. i gjeodezisë dhe G. B. - gjeometër, të cilët gjykatës ia kanë parashtruar raportin me shkrim nga vendi i ngjarjes të datës..., dhe atë vlerësues F. S., ekspert i licencuar i cili duke ju referuar të gjitha shkresave të lëndës, ka dhënë mendimin e tij me shkrim të datës..., ku ka identifikuar dhe vlerësuar paluajtshmeritë që janë objekt i vlerësimit dhe atë në shumë të përgjithshme prej ...€, në të cilën ekspertizë janë sqaruar dhe arsyetuar në mënyrë të gjithanshme të gjithë parametrat dhe kushtet në të cilat është bazuar vlerësimi, konstatimi dhe mendimi i tyre profesional, duke dhënë lartësinë e çmimit të paluajtshmërisë përkatëse të shpronësuar, në bazë të dhënave mbi vlerën qarkulluese në atë zonë, duke pasur parasysh edhe kriteret relevante ligjore të cilat kanë ndikuar në çmimin kushtues të sipërfaqes përkatëse të paluajtshmërisë, si distancën nga qendra urbane e pronës së paluajtshme që preket nga shpronësimi, zhvillimi rajonal i zonës ku ndodhet paluajtshmëria lëndore e shpronësuar, qasja në infrastrukturën publike: rruga, uji, kanalizimi, energjia elektrike, madhësia e ngastrës kadastrale, forma e saj, kushtet mjedisore dhe përshtatshmëria inxhinierike e tokës për të mbajtur struktura ndërtimore etj, si dhe duke marrë parasysh në kontekstin e mësipërm, edhe metodat përkatëse, si metodën krahasuese , metodën e kostove dhe metodën e të ardhurave etj.

Nuk qëndron pretendimi i kundërpropozuesit se eksperti nuk ka sqaruar se në formimin e çmimit të tregut cilët faktor kanë ndikuar, në vlerësimin e shumës në të cilën është obliguar kundërpropozuesja, duke pretenduar se vlerësimi i ekspertit është shumë i lartë dhe nuk përkon me vlerën e tregut në kohën e shpronësimit. Në këtë rast në ekspertizën e ekspertit rezulton qartë se janë marrë të gjitha rrethanat e rastit siç janë cekur edhe më lartë, si dhe duke marrë parasysh edhe metodat përkatëse, si metodën krahasuese, metodën e kostove dhe metodën e të ardhurave, andaj nuk qëndron pretendimi i kundërpropozuesit se ekspertiza është në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, kjo për faktin se kundërpropozuesja nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë se ekspertiza është bazuar në çfarëdo vlere të përmirësimit të pronës, apo objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, nga data e miratimit të vendimit për autorizim, e që do të ishte në kundërshtim me dispozitën e pretenduar nga kundërpropozuesja.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga kundërpropozuesja nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktvendimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale dhe lartësisë së kërkesës, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.49/24, datë 07.03.2024

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi